




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –JUNIK SKUPSTINA OPSTINE JUNIK -MUNICIPALITY OF JUNIK



Drejtoria për Administratë të
Përgjithshme

Duke u bazuar në nenin 68, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale,
Nr-03/L-040, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, hedh në:

Më datë 08.12.2022

DISKUTIM PUBLIK

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË JUNIKUT

Duke pas parasysh përmbushjen e kërkesave të qytetarëve dhe zbatimin e dispozitave ligjore, Komuna përdor mekanizmin e konsultimeve dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të tyre në propozimet për vendimet me interes të qytetarëve.

Andaj, pas leximit të parë në Kuvendin Komunal me dt. 30.11.2022, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut” e hedh në diskutim publik nga data 08.12.2022 deri më 23.12.2022.

Vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe komentet e juaja mund t'i dorëzoni në zyrën e Drejtorisë së Administratës në objektin e Komunës (në katin e parë), ku edhe mund të siguroni materialet për shqyrtim, çdo ditë pune prej orës 09.00 deri në ora 12.00. Këtë dokument mund ta gjeni edhe në faqen zyrtare të Komunës.

<http://kk.rks-gov.net/junik/>

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Leonora Shehu